



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë _____.____.2022

“PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1137, DATË 16.12.2020 “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT 2021–2025 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021–2023”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit. 2021 – 2025, dhe të Planit të Veprimit 2021 – 2023”, bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 1 e vendimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Miratimin e strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022-2025 dhe të planeve të veprimit 2022-2025”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Shtojca nr. 1 “Plani i Veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit 2021-2025”, zëvendsohet me shtojcën nr. 1 “Plani i Veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit 2022-2025”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

“1/2. Shtohet shtojca nr. 2 “Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planeve të veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA